

KORRIGJIM GABIMI MATERIAL

Në ligjin nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 9, datë 17.1.2025, bëhet korrigjimi i gabimeve materiale si më poshtë:

1. Në germën “e”, të pikës 1, të nenit 27, të ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i cili rregullon detyrimin për të dokumentuar të kontrolluesit dhe përpunuesit, citohet gabimisht termi **“përpunues”**, në vend të termit **“kontrollues”**. Më konkretisht, germa “e” citon: “nëse është e mundur, një përshkrim të përgjithshëm të masave teknike dhe organizative të sigurisë, të zbatuara në ambientet **e përpunuesit**”.

Nga fryma e kësaj pike rezulton e qartë që saktësimi është në të njëjtën frymë me vullnetin e ligjvënësve, pasi referenca është për kontrolluesin, ku pika 1 në tërësi rregullon detyrimin e këtij të fundit për të dokumentuar, ndërkohë që detyrimi për përpunuesin përcaktohet në pikën 2 të këtij neni.

Sa më sipër, në germën “e”, të pikës 1, të nenit 27 fjala **“përpunuesit”** të zëvendësohet me **“kontrolluesit”**.

2. Në rreshtin e dytë, të pikës 1, të nenit 60, të ligjit, numri **“25”** duhet të zëvendësohet me numrin **“26”**, pasi nga përmbajtja e nenit në fjalë kuptohet qartë që referenca është për nenin 26, i cili rregullon pikërisht marrëdhënien me përpunuesin.